

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

" Shërbimi për mirëmbajtjen e objekteve specifike WEB, Aplikacioni, Platforma e Kartës së Studentit, si dhe shërbimi hostimit të tyre"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 72267100-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

6,100,000 (gjashte milion e njeqind mijë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Rinisë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP 162/2020(i ndryshuar), nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP 162/2020 (i ndryshuar), nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin : Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja mesatare vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2021,2022,2023), nga data e zhvillimit të tenderit të jetë sa 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP 162/2020 (i ndryshuar), si dhe nenin 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 1,220,000 (një milion e dyqind e njezet mijë) lekë të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. b)për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 (i ndryshuar)“Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitetet e duhura për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë të gjitha kapacitetet teknike sipas pikës 2.3 në DST..

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë disponimin e numrit minimal të punonjëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë dokumentat provuese diplomë për punonjësit e mësipërm.

Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, mbajmë në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, , ku parashikohet që “Perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikë 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 (i ndryshuar) “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ”a”, ”b” ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

3. Operatori ekonomik duhet të disponoj minimum 1 (një) automjet, me qëllim që një nga specialistet e IT duhet të jetë I disponueshëm në 30 fakultete publike dhe 24 Universitete Jo Publike nëse do të ketë problematika me sistemin. Automjetin duhet ta kete në pronësi ose me qira dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikë 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 (i ndryshuar) “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma,”ç” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Bazuar në sasinë edhe grafikun e egzekutimit të shërbimit, Autoriteti Kontraktor, kërkon që operatori ekonomik ofertues të ketë këto kapacitete për burime njerëzore për shërbimin mirëmbajtje e objekteve specifike WEB, Aplikacion, Platëforma Karta e Studentit, si dhe shërbimi I hostimit të tyre sipas specifikimeve teknike përkatëse që të realizojë me sukses objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë, kërkesat aktuale për funksionalitet zgjerim cilësi e performancë si dhe shërbimet profesionale, sipas objektit të procedurës së prokurimit, duke përlllogaritur mënyrën e ofrimit të produkteve të reja, karakteristikat e duhura bashkëkohore teknologjike, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 (I ndryshuar) “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në çdo rast ku ka qenë e mundur është përdorur termi “ose ekuivalent” për të qenë gjithmonë në konformitet me zbatimin e legjislacionit të prokurimeve publike dhe akteve nën-ligjore në zbatim të tyre.

Sipas Shtojcës në DST.

NJËSIA E PROKURIMIT